Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0734

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 te Rregullores se Punës se OSHP-se, në përbërjen, Isa HAsani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Omega - I" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender" me numër të prokurimit 214-23-8083-1-2-1, inicuar nga Ministria e Punëve te Brendshme në cilësinë e Autoriteti kontraktues (AK), më 03/01/2024, mori këtë:

Vendim

1.Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "Omega - I" SH.P.K. me Nr. Protokolli 2023/0734 e datës 27/09/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender", me numër të prokurimit 214-23-8083-1-2-1, iniciuar nga Ministria e Punëve te Brendshme.

2. Mbetet ne fuqi "Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" të AK Ministria e Punëve të Brendshme, i datës, 12.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare" – ri-tender", me numër të prokurimit 214-23-8083-1-2-1.

3. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës ndaj Operatorit Ekonomik " Omega - I SH.P.K.", konform nenit 31 paragrafi 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 01.08.2023, Ministria e Punëve te Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender", me numër të prokurimit 214-23-8083-1-2-1. Ndërsa me datën 12.09.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "LIRIA" SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 80,000.00 €.

Me 14.09.2023, OE Omega - I SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 20.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.09.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Omega - I SH.P.K., me nr. 734/23 lidhur me aktivitetin "Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender", me numër të prokurimit 214-23-8083-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Omega - I" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi Ankuesi pretendon se "Duhet theksuar se AK "Ministria e Punëve te Brendshme" ne Vendimin e dërguar me date: 20.09.2023 nuk e ka shqyrtuar – përgjigjur asnjë prej pikave tona te pretenduara te Kërkesës për Rishqyrtim te cilin e kemi dërguar me date: 14.09.2023. Bazuar ne Njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues te publikuar me date: 12.09.2023, ne në emër te kompanisë tonë OMEGA-I sh.p.k. nuk kemi pranuar "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar", Letra standarde e cila është dërguar është ne emër te një Operatori ekonomik tjetër. Nëse kjo "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar" është menduar për kompaninë tone OMEGA –I sh.p.k. atëherë vendimi i komisionit vlerësues është i pa bazuar. Arsyetimi mbi refuzimin e tenderit është si me poshtë: Ju keni prezantuar listën e projekteve, mirëpo nuk keni asnjë projekt te ngjashëm ne listën e ofruar ashtu siç është kërkuar nga AK ne Njoftimi për Kontrate dhe Dosje te Tenderit, te gjitha projektet te cilat i keni prezantuar ne listën nuk kane te bëjnë asgjë me natyrën e prokurimit ne fjale. Ne FTD te dosje se tenderit ne Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar 1. Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme gjate periudhës (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) minimumi një projekt të përfunduar. Arsyetimi se ne nuk kemi asnjë projekt te ngjashëm ne listën e ofruar është i pa bazuar, përderisa janë kërkuar furnizime te ngjashme dhe jo furnizime te njëjta, ne kemi listuar dhe ofruar dëshmi te mjaftueshme për furnizimi te ngjashme, si shembull mund te gjeni disa prej furnizimeve te ngjashme te cilat i kemi realizuar: Komuna e Vushtrrisë - Furnizim me Gjeneratora - 18,300.00 Korporata Energjetike e Kosovës - Furnizim me pjesë rezervë për brenerat e mazutit - 23,741.60 Etj. Andaj ne si OE jemi te përgjegjshëm me çmim me te ulet dhe i plotësojmë te gjithat kushtet e kërkuara sipas dosjes se tenderit".

Pretendimi i dytë (II): Ankuesi pretendon se "Me date 13.09.2023 kemi kërkuar qasje ne dosje te tenderit te OE te rekomanduar për kontrate dhe na është mundësuar qasje me date: 13.09.2023. Referenca e cila është konsideruar nga ana e AK-se që është e ngjashme Referenca: Furnizime

me rezervar te naftës dhe Mazutit për nevojat e fabrikës se biberit, te cilën e ka prezantuar Liria sh,p,k, ne mes tyre dhe kompanisë private Ananas Impex, kemi vërejtur se nuk është paraqitur asnjë kontrate dhe ndonjë transfer bankar apo ndonjë dëshmi tjetër (evidentim te livrimit te tille) qe është realizuar projekti ne fjale ne mes tyre."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE Omega - I SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 69 të LPP të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 02/10/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 734/23, ndërsa me datë 13/10/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0734 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE " Omega - I "SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0734 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i pa bazuar pasi që "Sipas ekspertit shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e Dosjes së Tenderit, është kërkuar që OE të dorëzojnë kontrata të ngjashme me aktivitetin e prokurimit. OE ankues ka ofruar shumë kontrata por të cilat sipas mendimit të ekspertit nuk mund të konsiderohen si punë të ngjashme. Kontratat e cekura si "Furnizim me Gjeneratora" dhe "Furnizim me pjesë rezervë për brenerat e mazutit" nuk mund të konsiderohen si punë të ngjashme sepse janë shumë të ndryshme nga "Furnizimi me rezervuar të naftës", punë e ngjashme do kishte mundësi të trajtohej nëse kontrata e dytë do të kishte të bënte me Furnizim me rezervuarët e mazutit apo të ngjashme. Pra furnizimi me rezervuar nuk mund të konsiderohet si punë e ngjashme me furnizimin vetëm me pjesë rezervë, sepse kanë mjaft dallim. Andaj vlerësojmë që përderisa asnjëra nga kontratat e dorëzuara nuk i plotësojnë kriteret e DT-së, ky pretendim i ngritur është i pabazuar."

Pretendimi i dytë (II) ankimor është i pa bazuar pasi që "Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar edhe kontrata të punëve të ngjashme sipas kërkesave të DT-së, ndër të tjerash kontrata më e përafërt të cilën e ka dorëzuar është "Furnizime me rezervuar të naftës dhe mazutit për nevojat e fabrikës së biberit", pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë dëshmi për realizimin e kësaj kontrate nuk qëndron, sepse edhe sipas nenit 69 të LPP-së, por edhe sipas kërkesës së DT-së është kërkuar që për listën e kontratave të dorëzuar, duhet bashkëngjitur referenca ose çfarëdo dëshmie që dëshmon pranimin

përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e furnizimeve. Sipas kësaj kërkese, OE i rekomanduar ka dorëzuar referencë të lëshuar nga fabrika të cilën e ka furnizuar, përkatësisht një referencë të lëshuar nga Anans Impex shpk, e cila në mënyrë të detajuar cekë kontratën për të cilën është realizuar furnizimi, kohën, vendin dhe shumën e kësaj kontrate, edhe pse në kushte normale sipas LPP-së do të duhej të mbështetej edhe me ndonjë faturë e cila vërteton pagesën e realizuar, megjithatë përderisa një kërkesë e tillë nuk ka qenë e përfshirë në DT, atëherë sipas ekspertit nuk mund të dalim jashtë këtyre kërkesave, sepse edhe një gjë të tillë e ndalon LPP. Andaj konsiderojmë se kjo kërkesë është përmbushur në tërësi nga OE i rekomanduar ashtu siç kanë qenë kërkesat nga Autoriteti Kontraktues, dhe se pretendimi i OE ankues është i pabazuar."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Omega - I " SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Omega - I" SH.P.K, janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në ketë rast.

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, konsideron se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se i rekomanduari me çmimin më të lire të ofruar për këtë aktivitet të prokurimit është i papërgjegjshëm, andaj në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender", me numër të prokurimit

214-23-8083-1-2-1. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të Vërtetuar Vendimin e AK -B58 të datës 12.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender", me numër të prokurimit 214-23-8083-1-2-1.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës në fjalë" dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të paqëndrueshme ashtu siç janë elaboruara në raportin e ekspertit shqyrtues.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **" Omega - I " SH.P.K**
- Arkivës së OSHP-së: